

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë



**Plani Strategjik i Bankës Popullore të Republikës së
Maqedonisë për periudhën 2017-2019**

maj 2016

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 9 nga ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16) dhe neni 12 paragrafi 3 nga Rregullorja për planifikimin strategjik dhe operativ, Rr. nr. 02-15/I-1/2016 nga 28 Janar 2016, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

Planin Strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2017-2019

I. DISPOZITAT TË PËRGJITHSHME

1. Planin Strategjik i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) përcaktohet në bazë të misionit, vizionit dhe vlerat organizative të Bankës Popullore, në varësi nga mjedisi makroekonomike dhe sfidat kryesore dhe përmban qëllimet themelore strategjike për periudhën e ardhshme tre vjeçare.

2. Planin Strategjik rishikohet çdo vit dhe paraqet bazë për përgatitjen e programit për punë, me të cilën përcaktohen programet vjetore për realizimin e qëllimeve strategjike.

Planin strategjik përmban shtojcat në vijim:

- Bilanc projektues për gjendjen aktuale dhe për tre vitet e ardhshme;
- Plan për shpenzimet operative për tre vitet e ardhshme; dhe
- Kornizë për investimet e planifikuara për tre vitet e ardhshme.

II. MANDATI DHE KOMPETENCAT

3. Qëllimet kryesore të Bankës Popullore janë të përcaktuara në Ligjin për Bankën Popullore, sipas së cilit qëllimi kryesor i Bankës Popullore është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Qëllim tjetër, në varësi të qëllimit kryesor është që ajo të kontribuojë në ruajtjen e sistemit stabil financiar, konkurrues dhe të orientuar kah tregu, ndërsa qëllim i tretë është përkrahja e Bankës Popullore në politikën e përgjithshme ekonomike pa e rrezikuar realizimin e qëllimit kryesor dhe në pajtueshmëri me parimin e një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë.

III. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT

4. Misioni rrjedh nga qëllimet e përcaktuara me ligj dhe paraqet përkushtimin e Bankës Popullore për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve duke zbatuar strategjinë e zgjedhur monetare të ruajtjes së kursit stabil të denarit në raport me euron. Gjithashtu, Banka Popullore do të vazhdojë të jep kontribut lidhur me ruajtjen e stabilitetit financiar dhe rritjen e mirëqenies ekonomike dhe standardit jetësorë të qytetarëve.

5. Vizioni i Bankës Popullore është që ajo të njihet si një institucion i pavarur, i përgjegjshëm, profesional dhe transparent dhe që gëzon besim të lartë dhe kredibilitet në opinion.

6. Vlerat kontribuojnë në arritjen e misionit dhe e përkrahin vizionin e Bankës Popullore, nëpërmjet forcimit të kulturës organizative, rritjes së efektivitetit në punë, rregullimi i

marrëdhënieve ndërmjet punëtorëve, zhvillimi i përgjegjësisë dhe vetëdijesimit për detyrat e punës dhe krijimin e një mjedisi pozitiv

IV. QËLLIMET STRATEGJIKE TË BANKËS POPULLORE

7. Në periudhën e ardhshme tre vjeçare, Banka popullore do të jetë e fokusuar në realizimin e qëllimeve strategjike në vijim:

Qëllimi strategjik 1

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve përmes kursit stabil të denarit në raport me euron.

Mjedisi ku do të realizohet ky qëllim në tre vitet e ardhshme vlerësohet si periudhë e rimëkëmbjes së mëtutjeshëm nga „recesioni i madh“ dhe normalizimin e rrjedhave të përgjithshme. Edhe përveç stabilizimit gradual të rrjedhave financiare dhe ekonomike, rimëkëmbja ekonomike në korniza globale edhe më tej mbetet e pasigurt. Ky konstatim vlen edhe për euro-zonën, si partneri jonë i rëndësishëm ekonomik, ku rreziku për rritje të dobët ekonomike të prolonguar, edhe pse i zvogëluar me masat e ndërmarra nga Banka Qendrore Evropiane, edhe më tej është prezent. Gjithashtu, e shprehur është ndryshueshmëria e kushteve të tregjeve globale financiare, ndërsa rrezik me rëndësi globale janë edhe realizimet më të dobëta ekonomike në ekonomitë me zhvillim të shpejtë. Rreziqet lidhur me çmimin e produkteve primare, dinamika e të cilave në periudhën e kaluar ishte e ndryshueshme, janë prezent edhe më tej. Kohëve të fundit më të shprehura janë rreziqet nga karakteri gjeopolitik, ku një pjesë e tyre çuan deri te kriza e refugjatëve, e cila ka edhe efekt ekonomik. Kërcënimi për terrorizëm, në korniza globale, gjithashtu, fitoi në peshë. Përveç mjedisit të jashtëm të pasigurt edhe konteksti turbulent i politikës vendore është faktor që në masa të mëdha mund të ndikojë në mjedisin dhe realizimin e qëllimeve strategjike të Bankës Popullore.

Realizimi i suksesshëm i qëllimit për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve nënkupton të pasurit në dispozicion një infrastrukturë solide analitike. Që andej, procesi për marrjen e vendimeve monetare për realizimin e këtij qëllimi do të bazohet në përpunimin e projekteve në kohë dhe me kualitet të lartë, analiza dhe raporte të rregullta kualitative me pamje të qarta për lëvizjet e ardhshme ekonomike. Në periudhën e ardhshme tre vjeçare edhe më tej do të punohet në përmirësimin e vazhdueshëm të kualitetit të procesit të projektimit dhe analizë të politikave, nëpërmjet përmirësimit të portfolios të modeleve të tashme si dhe nëpërmjet pasurimit të tij me modele të reja dhe teknika të reja më të sofistikuara. Procesit i vendimit monetar edhe më tej do të mbështetet me analizat makroekonomike të fokusuar në dobësitë potenciale në ekonominë e vendit. Përmirësimi i përmbajtjes dhe mënyra e prezantimit të kornizës së përdorur për parashikimin në kuadër të raporteve të rregullta do të zhvillohet në kontinuitet, me fokus në lëvizjet afatmesme të variave makroekonomike, ndikimet e tyre monetare dhe rreziqet kyçe.

Rritja e transparencës do të zmadhojë të kuptuarit e mënyrës të vendimmarrjes monetare dhe arsyet për vendimet e marra monetare nga ana e subjekteve ekonomike dhe do të ndikojë në formimin e pritjeve të tyre të ardhshme. Ndikimet ndaj pritjeve të subjekteve ekonomike do të rrisin efikasitetin e transmetimit monetar.

Duke pasur parasysh mjedisin makroekonomik, Banka Popullore do të vazhdojë menaxhim të përshtatshëm me instrumentet monetare në mënyrë që do të sigurojë menaxhim efikas me likuiditetin e sistemit bankar dhe ruajtjen e baraspeshës së tregut devizor, me këtë, ruajtje të vlerës stabile të kursit devizor. Duke pasur parasysh prezencën e pasigurisë, zbatimin e politikës monetare në periudhën e ardhshme do të jetë e fokusuar në sajimin e hershëm të rreziqeve dhe reagimin efikas në kohë nëpërmjet instrumenteve monetare që do të sigurojnë realizim të suksesshëm të qëllimeve monetare. Ruajtja e kursit stabil devizor të denarit në raport me euron, mbetet prioritet kryesor i Bankës Popullore dhe këtë prioritet ajo do të vazhdojë ta realizojë me sukses në periudhën e ardhshme, për të cilën ka në dispozicion një nivel të përshtatshëm të rezervave devizore dhe instrumente efikase monetare. Edhe në periudhën e ardhshme, Banka Popullore do të vazhdojë me promovim aktiv të kursimit në denar, respektivisht do të vazhdojë të sjellë masa që do të nxisin bankat të krijojnë produkte depozitare që stimulojnë kursim në valutat vendore. Me këtë, Banka Popullore do të vazhdojë të përkrahë procesin e de-euroizmit të ekonomisë vendore prezente në vitet e fundit, që pjesërisht është si rezultat i metodave të sjella monetare.

Qëllimi strategjik 2

-RUAJTJA E SISTEMIT STABIL DHE TË SIGURT BANKAR, SI PARAKUSHT KRYESORË PËR STABILITETIN FINANCIAR DHE PËR RITJE TË QËNDRUESHME EKONOMIKE NË VEND.

Mjedisi ku do të realizohet ky qëllim strategjik në tre vitet e ardhshme vlerësohet si periudha e stabilizimit të rrjedhave të ekonomisë dhe në sektorin bankar, të cilët janë të shkaktuara nga kriza aktuale politike si dhe realizimet e dobëta ekonomike të prolonguara të Bashkimit Evropian. Pritet kapitalizimi dhe likuiditeti i kënaqshëm të mbesin anët më të forta të sistemit bankar të vendit. Menaxhimi me pjesën problematike të portfolëve kreditorë si dhe gjenerimi i kënaqshëm dhe qëndrueshëm i profitabilitetit të bankave do të jenë sfida të rëndësishme për ta. Pritet që konkurrenca në mes të bankave edhe më tej të rritet, veçanërisht në tregun e popullatës. Me aplikimin e kornizës së re regulative për shërbimet e pagesave, pritet që përveç bankave, në tregun financiar të paraqiten edhe institucione të reja për pagesa. Me këtë, konkurrenca mes tyre do të rritej dukshëm, që do të sjell deri te oferta të reja, kualitative, edhe më të lira të shërbimeve financiare për klientët. Në kushte të normave akoma të ulta të interesit, në kërkim të rendimenteve më të larta, pritet që bankat me madhësi të mesme ta rrisin ofertën me produkte të reja më komplekse financiare. Pritet edhe rritje më e madhe e transparencës së bankave në ofertën e kushteve financiare në aspekt të çmimit dhe kualitetit.

Bankat edhe më tej do të ballafaqohen me rreziqe për zbatimin e rregullativës së gjerë dhe komplekse e njohur si Bazel III, para se gjithash, standardet e reja kapitale dhe koeficientet e likuiditetit si dhe standardet ndërkombëtare për informimet financiare (SNIF 9), veçanërisht në pjesën e menaxhimit me rrezikun kreditor.

Pikërisht mjedisi i ri rregullator, si dhe konkurrenca e rritur ndërmjet bankave, duhet të paraqesin nxitje shtesë për intensifikimin e proceseve të konsolidimit të sistemit bankar si dhe ndryshime pronësore.

Stabiliteti financiar në vend do të jetë nën ndikimin edhe të realizimit të sektorit financiar jo bankar, para se gjithash fondet penzionale dhe kompanitë e sigurimeve, të cilët viteve të fundit përfitojnë rëndësi më të madhe në tregun financiar. Që andej, vlerësimi i rregullt i rreziqeve tek segmentet e ndara, por edhe të mundësia e daljes së rreziqeve nga njëri në një segment tjetër të sistemit financiar, janë me rëndësi të madhe për mbajtjen stabilitetit të tyre.

Në periudhën e ardhshme afatmesme, Banka Popullore do të jetë e drejtuar kah ruajtja e mëtejshme e stabilitetit dhe sigurisë së sistemit bankar, me këtë edhe të stabilitetit financiar, nëpërmjet mbikëqyrjes së rregullt të punës së bankave dhe institucioneve tjera financiare, forcimit të mëtejshëm të kapacitetit të mbikëqyrjes për monitorim dhe vlerësim të mënyrës së menaxhimit me rreziqet tek bankat si dhe kapitalin e duhur të bankave në varësi të profilit total të rrezikut të bankave. Gjithashtu, do të vazhdojë procesi i harmonizimit të mbikëqyrjes bankare dhe kornizës rregullative me parimet e reja Bazel për mbikëqyrje efikase bankare, do të vendoset direktivë e re bankare nëpërmjet të sjelljes së një ligji të ri për bankat (institucionet kreditore), do të fillohet me zbatimin e kornizës së re rregullative për shërbimet e pagesave dhe do të avancohet korniza rregullative dhe institucionale për zgjidhje të bankave problematike. Në fushën e stabilitetit financiar, do të punohet në forcimin të mëtejshëm të punës analitike dhe hulumtuese.

I tërë procesi do të jetë i mbështetur përmes zgjerimit të bashkëpunimit me organet e brendshme dhe të jashtme mbikëqyrëse. Në kuadër të aktiviteteve të iniciativës së Vjenës, me rëndësi të veçantë është vendosja e një mekanizmi për bashkëpunim me bankën Qendrore Evropiane, që duhet të kontribuojë në mbikëqyrje të pandërprerë të një pjese të grupacioneve bankare të euro-zonës që janë prezentë në Republikën e Maqedonisë.

Qëllimi Strategjik 3

- Menaxhimi efikase me rezervat devizore të Republikës së Maqedonisë përmes ekuilibrit optimal mes parimeve të sigurisë, likuiditetit dhe kthimi nga menaxhimi.

Menaxhimi me rezervat devizore do të realizohet në përputhshmëri me kushtet vendore dhe ndërkombëtare, duke respektuar parimet e sigurisë, likuiditetit dhe profabilitetit. Në këtë kontekst, me qëllim për të siguruar ekuilibër optimal përmes kthimit dhe rrezikut nga investimet, parashihet përshtatja e strategjisë investuese në drejtim të rritjes së investimeve në instrumente financiare dhe valuta me rendimente pozitive dhe pikëpamje më stabile ekonomike. Gjithashtu, Banka Popullore do të vazhdojë me përforcimin e mëtejshëm të kapacitetit institucional për menaxhim me rezervat devizore nëpërmjet pjesëmarrjes në programin e përshtatshëm për menaxhim me rezervat devizore të Bankës Botërore (RAMP), në kuadër të së cilës janë të parapara aktivitete për avancimin e mëtejshëm e procesit për menaxhim dhe investim të rezervave devizore në përputhshmëri me praktikën më të mira të rekomanduara nga Banka Botërore, rritja e efikasitetit gjatë menaxhimit me rezervat devizore nëpërmjet zbatimit të strategjive të reja për tregti, sigurimin e ndihmës teknike, këmbimin e përvojave dhe trajnime të përhershme të të punësuarve nga njësitë organizative që janë të kyçura në procesin e menaxhimit dhe investimit të rezervave devizore.

Qëllimi strategjik 4

- **Mbështetja e zhvillimit të tregjeve vendore financiare.**

Banka Popullore edhe ne periudhën e ardhshme afatmesme do të vazhdojë me pjesëmarrje aktive dhe mbështetje e zhvillimit të tregjeve vendore financiare nëpërmjet kyçjes në aktivitete për zbatim të kornizës regullative evropiane në rregullativën e tregjeve vendore financiare, avancimin e infrastrukturës së tregut dhe mbështetjen e zhvillimit të instrumenteve të reja financiare, që do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit të tregjeve vendore financiare. Në këtë drejtim parashikohet të rishqyrtohet rregullativa lidhur me platformat elektronike për tregti në pajtueshmëri me drejtimet nga ndryshimet e parashikuara ligjore për tregti me instrumentet financiare. Me këtë, do të rishqyrtohet edhe korniza e infrastrukturës cila I përfshin tregtinë dhe barazimin e transaksioneve me instrumentet financiare në funksion të efikasitetit më të madh dhe transparencës. Fokusi i aktiviteteve të Bankës Popullore në këtë fushë do të jetë edhe kah promovimi e prodhimeve derivative për siguri nga rreziqet e kamatës, me të cilën do të pasurohet spektri i instrumenteve për menaxhim me rreziqet tregtare në kushte të lënies gradual të praktikës së bankës për përdorimin e normave të përshtatshme të interesit. Në këtë kuptim, parashikohet vendosja e një indeksi tregtar të ri lidhur me derivativin nga normave të interesit (shkëmbim i interesit i indeksuar për norma referente të interesit gjatë natës), në bazë të kuotave të bankës, që do të kontribuojë në rritjen e informacioneve për pritshmëritë e tregut. Në këtë mënyrë, pritjet të rritet seti i të dhënave informative për pjesëmarrësit në treg, gjithashtu edhe për kushtet fillestare nëse tregtia me këto produkte do të jetë me intensitet më të ulët.

Qëllimi strategjik 5

- **Rrija e efikasitetit të sistemit për furnizim dhe përpunim të kartëmonedhave dhe monedhave si dhe rritja e kualitetit dhe funksionalitetit të parave të gatshme në qarkullim.**

Në drejtim të liberalizimit të tregut të shërbimeve të gatshme nëpërmjet stimulimit dhe krijimit të kushteve konkurrençe, do të vazhdojnë angazhimet për pajtueshmëri të mëtejshme të rregullativës nënligjore e cila rregullon punën e gatshme me standardet për sigurimet-siguruese dhe teknikat-teknologjike të cilat vlejné në vendet e EU. Gjithashtu, për përcjelljen e zbatimit të standardeve të përcaktuara dhe kriteriumet për ruajtjen e kualitetit të parave në qarkullim, do të punohet në zhvillimin dhe thellimin e mëtejshëm të funksionit kontrollues të Bankës Popullore dhe do intensifikohen trajnimet për të punësuarit në banka dhe qendra për para te gatshme. Njëkohësisht, do të intensifikohen aktivitetet hulumtuese për rishqyrtimin e teknikave dhe teknologjive të reja për shtypje dhe dhe prodhim të parave, arrijtjet e larta në fushën e mbrojtjes së sigurisë së parave dhe mundësitë për zbatimin e tyre në dizajnin e përhershëm ose të ndryshueshëm të kartëmonedhave dhe monedhave.

Qëllimi strategjik 6

- **Ruajtja e shkallës më të lartë të sigurisë, stabilitet dhe efikasitet të sistemit vendore për pagesë dhe sigurimin e kushteve për lidhje ndërkuftare të sistemit për pagesë.**

Miratimi i kornizës së re rregullative të bazuar në të drejtën e Bashkimit Evropian paraqet sfidë kyçe, e cila pritet të kontribuojë në paraqitjen e instrumenteve të reja të pagesës, institucione të pagesave dhe sisteme të pagesave në vend dhe të rrisë konkurrencën, efikasitetin, transparencën dhe mbrojtjen e shfrytëzuesve të shërbimeve të pagesave. Njëkohësisht, do të vazhdohet me aktivitete për fillimin me punë të sistemit ndërkufitarë për pagesa në euro përmes Sistemi ndërbankar i pagesave të Maqedonisë (SNPM - MIPS) i Bankës Popullore, në kuadër të së cilës do të kryhet lidhja e MIPS me sistemin TARGET 2¹, që do të mundësojë shpenzime më të ulëta për pagesat ndërkufitare, si për Bankën Popullore ashtu edhe për bankat komerciale të cilat do të jenë të lidhura nëpërmjet këtij kanali. Më tutje, pritet harmonizimi gradual i kushteve për kryerjen e pagesave në vend dhe pagesave ndërkufitare. Në periudhën e ardhshme afatmesme Banka Popullore do të vazhdojë me avancimin e mëtejshëm të punës në prapavijë në pajtueshmëri me praktikat dhe standardet e punës së Bankë Qendrore Evropiane, dhe do të vazhdojnë edhe aktivitetet për avancimin e rolit mbikëqyrës të Bankës Popullore në fushën e punës së sistemeve për pagesë.

Qëllimi strategjik 7

- **Zhvillimi i veprimtarisë së hulumtimit në fushat që janë më rëndësi kyçe për realizimin efikas të qëllimeve të Bankës Popullore.**

Zbatimi i politikës monetare në një ekonomi shumë të hapur e cila kalon përmes procesit të reformave strukturore është relativisht një proces kompleks. Që këtu, për politikë monetare efikase është numër i madh i hulumtimeve janë të nevojshme me qëllim të që më mire të kuptohet transmetimi monetar, ekonomi reale, lidhje makro financiare dhe fusha tjera që janë me rëndësi kyçe për përcaktime efikase dhe realizimin e politikës monetare. Zhvillimi i mëtejshëm i mjeteve ekonometrike do të paraqes bazë për avancimin e mëtejshëm të hulumtimeve.

Qëllimi strategjik 8

- **Sigurimi i të dhënave kualitative statistikore, plotësisht në pajtueshmëri me standardet statistikore ndërkombëtare dhe evropiane, duke pasur parasysh ngarkesën e raportimit dhe efikasitetin e tyre, desiminimin në kohë dhe të thjeshtë deri te shfrytëzuesit.**

Në fushën e statistikës, në periudhën e post-krizës është rritur vetëdijesimi për rëndësinë e detajeve kualitative dhe të dhënave makroekonomike statistikore në kohë duke krijuar dhe ndërmarrë masa nga ana e bartësve të politikave ekonomike. Gjithashtu, e dukshme është edhe nevoja për mundësi të qasjes më të thjeshtë deri te këto të dhëna për publikun më të gjerë. Gjithashtu, duke pasur parasysh trendin e rritur të tregut dhe integritit financiar të Republikës së Maqedonisë në rrjedhat globale ekonomike, si dhe përcaktimin strategjik për anëtarësim në UE, sfidat kryesisht janë të lidhura me zbatimet e standardeve ndërkombëtare statistikore dhe harmonizim gradual me kërkesat evropiane sa i përket shtrirjes dhe kualitetit të statistikave makroekonomike.

¹ Sistem i pagesës për barazim të euros në kohë reale në bruto-bazë të menaxhuar nga Eurosistemi.

Që andej, realizim i suksesshëm i këtij qëllimi nënkupton vazhdimësinë e aktiviteteve të drejtuara nga avancimi i mëtejshëm i kualitetit dhe mbulimit të statistikave të përhershme eksterne dhe monetare në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe evropiane statistikore. Gjithashtu, do të vazhdojnë edhe aktivitetet të drejtuara kah zgjerimi i diapazonit të statistikave të disponueshme me hulumtime të reja statistikore, para se gjithash me statistikën e llogarisë financiare dhe statistikën e letrave me vlerë. Mbështetje të madhe për pasurimin e kompletit të të dhënave statistikore dhe thjeshtëzimin e qasjes së publikut deri te ata do ta mundësojë edhe zbatimin e projektit për ndërtimin e sistemit të menaxhimit me bazat e të dhënave në kuadër të Bankës Popullore. Mbulimi i pasuruar i të dhënave statistikore, i plotësuar me shpjegime më të detajuara metodologjike, edhe më shumë do të përmirësojë procesin e vendimmarrjes së bartësve të politikave makroekonomike, dhe do të kontribuojë edhe informim më të mirë për publikun, në përgjithësi.

Qëllimi strategjik 9

- Përgatitja e Bankës Popullore për kyçe dhe anëtarësim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Banka Popullore do të vazhdojë me aktivitete për përmbushjen e kërkesave operative dhe institucionale për anëtarësim në sistemin Evropian të bankave qendrore. Në këtë kontekst, do të punohet në harmonizim e mëtejshëm me legjislacionin evropian, standarde dhe praktika më të mira për veprimtari të bankave qendrore, si dhe në përforcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve administrative të Bankës Popullore. Gjithashtu, në periudhën e ardhshme afatmesme, planifikohet forcimi i bashkëpunimit teknik me bankat e tjera qendrore dhe institucionet ndërkombëtare financiare, si dhe shfrytëzimin e mundësive në suaza të instrumenteve në dispozicion të UE.

Qëllimi strategjik 10

- Ndjekja e trendeve në veprimtarinë e bankave qendrore, forcimi i fleksibilitetit në kuadër të ndryshimeve që i imponon mjedisi, menaxhim efektiv me rreziqet në të gjitha segmentet e punës, sigurimin e vazhdimësisë së punës dhe siguria e sistemit informativ, përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësia sociale e institucionit.

Në periudhën e ardhshme afatmesme Banka Popullore do të vazhdojë të zhvillojë dhe avancojë evidentimin dhe raportimin financiar, që do të mundësojë menaxhim me financat, planifikim dinamik dhe monitorim të bilancit të Bankës Popullore. Kontrollim i shpenzimeve, realizimi i kthimit të investimeve financiare me rrezik më të vogël të ekspozimit dhe optimizimin e të ardhurave nga puna e rregullt, do të jenë shtylla kryesore e angazhimeve të Bankës Popullore.

Ndryshimet në mjedis dhe ndikimi i tyre në punën e Bankës Popullore e potencojnë rëndësinë e planifikimit strategjik. Në këtë fushë, vëmendje e veçantë do të kushtohet zhvillimit të kapaciteteve për përcaktim real dhe objektiv të prioriteteve në punën, monitorimin dhe vlerësimin e realizimeve, duke pasur parasysh potencialin njerëzor, mjetet financiare dhe rreziqet në punë. Zhvillimi i pjekurisë institucionale paraqet element të rëndësishëm për implementim të suksesshëm të misionit të Bankës Popullore. Në këtë drejtim, një prej prioriteteve më të rëndësishme të Bankës Popullore në periudhën e re strategjike është zhvillim

i mëtutjeshëm i kapitalit bashkëkohor dhe kompetent njerëzor, avancim menaxhimit korporativ dhe thellim i sistemit të vlerave në pajtueshmëri me praktikat bashkëkohore veprimtarinë e bankës qendrore. Gjatë punësimeve të reja, vëmendje të veçantë do ti kushtohet përfaqësimit të drejtë të komuniteteve etnike dhe strukturës së barabartë gjinore, duke i respektuar parimet e kualitetit, profesionalitetit dhe kompetencës.

Nga ana tjetër, rritja e krimit kompjuterik në suaza botërore, kriza e refugjatëve dhe e migrimit si dhe sfidat e brendshme politike, kërkojnë nevojë për monitorim më të shpeshtë të rreziqeve dhe identifikim në kohë të duhur të rreziqeve e të reja, përforcimin të masave të sigurisë në sistemin informativ të Bankës Popullore dhe masave për sigurim të vazhdueshmërisë së punës së Bankës Popullore.

Në fushën e rregullativës, Banka Popullore aktivisht është e kyçur në përgatitjen, ndryshimet dhe plotësimin e më shumë ligjeve, ndër të cilat: Ligji për Bankën Popullore, Ligji për shërbimet e pagesave dhe Ligji për instrumentet financiare. Pas miratimit të tyre, Banka Popullore do të vazhdojë të punojë në përgatitjen e rregullativës nënligjore e lidhur me këto ligje. Gjithashtu, ndryshimet rregullative kërkojnë monitorim të përhershme dhe kontroll të rrezikut ligjor, kështu që vëmendje më e veçantë do ti kushtohet kontrollit të pajtueshmërisë së punës së Bankës Popullore me rregullat.

Gjatë implementimit të proceseve rregullte rregullta të punës, Banka popullore do vazhdojë të mbajë kushtet ekzistuese të punës në pajtueshmëri me kërkesat e biznesit, standardet dhe normat e përcaktuara në Republikën e Maqedonisë. Në këtë drejtim, Banka Popullore do të punojë në ndryshim të sigurt dhe efikas të teknologjisë informative në punë nëpërmjet përmirësimit të përhershëm të sistemit informativ në pajtueshmëri me praktikat më të mira ndërkombëtare nga fusha e menaxhimit të IT-shërbimeve. Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve për ndërtimin e objektit të ri, në periudhën e ardhshme afatmesme do të punohet në sigurimin e një mjedisi punues dhe pajisje optimale ekologjike, të sigurt dhe tekniko-teknologjike, në drejtim të rritjes së realizimeve profesionale të Bankës Popullore. Në pjesën e prokurimit publik, Banka Popullore ndjek trendin e prokurimeve elektronike në nivel kombëtar, përmes avancimit të vazhdueshëm të procesit, futjen e procedurave elektronike për prokurime publike, thjeshtësimin e procedurave dhe zhvillimin e zgjidhjeve të reja dhe përditësimin e zgjedhjeve ekzistuese aplikative.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMATRE

8. Plani hyn në fuqi në ditën e miratimit, ndërsa do të zbatohet nga 1 janari 2017.

9. Me fillimin e implementimit të këtij plani, Plani strategjik i Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë SP. nr. 02-15/V-1/2015 nga 7 maj 2015 shfuqizohet.

S. P. NR. _____
26 MAJ 2016
SHKUP

GUVERNATOR
dhe Kryetar i Këshillit të
Bankës Popullore të Republikës së
Maqedonisë
Dimitar Bogov